

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-132/12

Prishtinë,
17 shtator 2013

Në çështjen juridike të:

R. L.

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës

kundër

I. J.

Pala ankuese/Pala përgjegjëse në kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, gjyatarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/148/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA42175) të datës 19 prill, 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 shtator 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Anulohet në mungesë të juridiksionit vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/148/2012 i datës 19 prill 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA42175.**

2. Hedhet poshtë pasi që nuk është në juridiksion të AKP-së kërkesa e R. L. e regjistruar me numrin KPA42175.
3. Obligohet paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 60 euro (gjashtëdhjetë euro) në buxhetin e Kosovës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 21 gusht 2007, R.L. si trashëgimtar i bartësit të së drejtës pronësore ka parashtruar kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar konfirmim e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin në posedim të ngastrës nr. 581/2, që ndodhet në fshatin Sopi në Suharekë me sipërfaqe prej 11,70 m². Ai deklaron që babai i tij i ndjerë ka qenë pronar i pronës në fjalë e cila është uzurpuar nga persona të panjohur.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:

- Certifikatën e vdekjes të N. L. që dëshmon datën e vdekjes 8 tetor 2002;
- Certifikatën e vdekjes së J.L. që dëshmon datën e vdekjes 12 mars 1976;
- Kontratën e shitjes së tokës mes G. Sh. N. dhe L. M. të parcelës 0/92 e cila është verifikuar në Gjykatën e Qarkut në Suharekë më 31.12.1958 me nr. OV Nr. 331/58;
- Fletën poseduese nr. 76 e lëshuar nga Republika e Serbisë, Qendra Republikane për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Patundshmëri në Prishtinë, Zyra Kadastrale në Suharekë me kërkesën nr. 952-1/2003-867 që tregon se parcela kadastrale nr. 581/2 është regjistruar në emër të J. N.L.;
- Certifikatën e lindjes së paraqitësit të kërkesës;
- Letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës, lëshuar më 17 nëntor 2003.

AKP-ja e ka verifikuar fletën poseduese, letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës dhe certifikatën e vdekjes së N. L. dhe certifikatën e patundshmërisë sipas detyrës zyrtare.

Më 5 maj 2008, ekipi i AKP-së e vizitoi pronën në fjalë në Suharekë. Ekipi shënoi në raportin e tij që toka ishte uzurpuar nga I. J. i cili ishte i pranishëm në pronë gjatë vizitës duke deklaruar që kishte të drejtë pronësore ndaj pronës falë marrëveshjes për këmbimin e tokave. Raporti gjithashtu i referohet faktit që AKP-ja e kontaktoi paraqitësin e kërkesës po të njëjtën datë për qartësime dhe ai konfirmoi që ai e ka këmbyer pronën me z. I. dhe D. J. në vitin 1981. Raporti i dytë njoftues i AKP-së i datës 4 maj 2010 i pasqyrore të njëjta argumente të palës përgjegjëse në kërkesë.

Poseduesi I. J. e parashtroi njoftimin e pjesëmarrjes të datës 1 qershor 2010. Ai e parashtroi letërnjoftimin e lëshuar më 17 janar 2011, certifikatën nr. UL-72116043 – 00052 dhe një deklaratë me shkrim lidhur me pretendimet e tij. Në deklaratën e tij me shkrim, ai shpjegoi që e kishte kontratën e këmbimi me N. L. me çka ngastra nr. 581/2 i ishte dhënë atij nga ky i fundit në këmbim për ngastrën kadastrale nr. 1045/1 që ndodhet në “rupa drum”.

AKP-ja e shënoi datën e humbjes së pronësisë të paraqitësit të kërkesës të jetë 1 janar 1981 në raportin e saj parashtruar Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC). Aneksi i atij raporti thotë, kur u kontaktua nga Sekretaria, paraqitësi i kërkesës i kërkoi AKP-së nëse mund t'i këmbenin shënimet kadastrale dhe atij t'ia kthenin në pronësi ngastrën nr. 1045/1. AKP-ja e refuzoi kërkesën për kthim të ngastrës në vend të ngastrës së kërkuar nr. 581/2 meqë kërkesa erdhi pas afatit të pranimit të kërkesave.

Më 19 prill 2012, KPCC me vendim KPCC/D/A/148/2012 ia pranoi kërkesën meqë paraqitësi i kërkesës e kishte të drejtën e pronësisë ndaj pronës së kërkuar. Në arsyetim, në veçanti për kërkesën nr. 42175, KKPK-ja thotë që paraqitësi i kërkesës pretendon që babai i tij i ndjerë si bartës i së drejtës pronësore e ka këmbyer ngastrën në fjalë nr. 581/2 me ngastrën e palës përgjegjëse në kërkesë nr. 1045/1 para konfliktit të vitit 1999; megjithatë, ky këmbim ende nuk ishte pasqyruar në shënimet kadastrale. KKPK-ja përfundoi që meqë të dy palët u pajtuan që meqë ka pasur këmbim pronash, kërkesa qëndron për ngastrën nr. 1045/1 por jo për ngastrën fillimisht të kërkuar.

Vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës më 24 shtator 2012 ndërsa palës për përgjegjëse në kërkesë më 28 shtator 2012, ndërsa ky i fundit parashtroi ankesë në 11 tetor 2012.

Pala ankuese e kundërshtoi vendimin e KKPK-së në bazë të gabimit thelbësor ose shkeljes serioze të së drejtës materiale dhe procedurale. Ai deklaroi që nuk ka pasur mundësi të mbrojtjes efikase dhe që parimi i barazisë së palëve është shkelur meqë dëshmitarët e tij që do të dëshmonin për këmbimin e tokës nuk u dëgjuan nga Komisioni.

Më 4 prill 2013, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur përgjigje në ankesën e I. J. duke kërkuar refuzimin e ankesës nga njëra anë dhe nga ana tjetër duke deklaruar që KKPK-ja e ka miratuar vendimin në arsyetim jo për ngastrën të cilën e kishte kërkuar fillimisht por lidhur me ngastrën nr. 1045/1; megjithatë kjo nuk pasqyrohet në vendimin e konfirmuar. Ai kërkoi ndryshimin e vendimit për t'u miratuar e drejta e tij ndaj ngastrës nr. 581/1(si shtesë) dhe 581/2 dhe deklaroi që është i gatshëm ta pranojë ngastrën nr. 1045/1 por me kusht që të ketë ndonjë vendim të Komisionit në bazë të të cilit ai të mund ta regjistronte pronën në emrin e tij.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e palës përgjegjëses në kërkesë është e pranueshme. Ajo është parashtruar brenda afatit prej 30 ditësh në përputhej me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Kërkesa e paraqitësit të kërkesës në përgjigjen e tij në ankesës lidhur me ndryshimin e vendimit nuk është e pranueshme meqë nuk është parashtruar me kohë në formë ankese.

Nuk është kontestuar që paraqitësi i kërkesës e ka paraqitur fletën poseduese të ngastrës nr.581/2 meqë lënda e kërkesës së tij është regjistruar në AKP. Megjithatë, AKP-ja si edhe KKPK-ja e kanë vërtetuar që paraardhësi i paraqitësit të kërkesës N.L. e kishte këmbyer ngastrën nr. 581/2 me palën përgjegjëse I.J. dhe e ka marrë ngastrën nr. 1045/1 në këmbim.

Siç është shënuar në raportin njoftues të AKP-së të datës 5 maj 2008, paraqitësi i kërkesës e ka konfirmuar këmbimin e pronës së kërkuar me zotërinjtë I. dhe D.J. në vitin 1981. Data e humbjes së pronës është shënuar të jetë 1 janar 1981 nga AKP-ja në raportin e përpunimit të kërkesës të dërguar KKPK-së. Paraqitësi i kërkesës dëshiron të dijë nëse marrëveshja do të ekzekutohet plotësisht nga aspekti i pronës së këmbyer nga paraardhësi i tij. Gjatë procedurës, ai madje kërkoi nga AKP-ja kompensim për ngastrën 1045/1 në të vend të ngastrës 581/2 që është kërkuar fillimisht. KKPK-ja e verifikoi pronësinë e paraqitësit të kërkesës ndaj ngastrës nr. 581/2 në bazë të fletës poseduese nr. 76 por e miratoi kompensimin në arsyetimin e saj sa i përket pronës së këmbyer, ngastra nr. 1045/1, për të cilën paraqitësi i kërkesës nuk ka parashtruar ndonjë dokument që e vërteton të drejtën e tij pronësore. Komisioni nuk e mori vendimin në bazë të kërkesës, siç parashihet me nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, por në kërkesën e ndryshuar të paraqitësit të kërkesës për një pronë tjetër.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhrin e Komisionit për kthim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë ndaj patundshmërisë private por gjithashtu edhe ai ose ajo tash nuk mund t'i ushtrojë ato të drejta pronësore nga rrethanat që ndërliken drejtpërdrejt me ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Lidhur me rastin aktual, Gjykata Supreme vërtetoi që paraqitësi i kërkesës nuk e kishte humbur pronësinë ndaj pronës së kërkuar (ngastra nr. 581/2) lidhur me ose që rezultoi nga konflikti i armatosur por shkak i këmbimit të tokave që ndodhi mes paraardhësit të tij N.L. dhe palës përgjegjëse, shumë kohë para konfliktit. Ekzistimi i këmbimit të tokave nuk është kontestuese dhe sa i përket faktit nëse ai këmbim është i vlefshëm apo jo nuk është relevante për këtë procedurë.

Gjykata Supreme konstaton se çështja nuk është në juridiksionin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës ose në juridiksionin e Kolegjit të Ankesave të AKP-së të Gjykatës Supreme. Duke konsideruar që KKPK-ja ka vendosur për kërkesën përkundër mungesë së juridiksionit meqë humbja e pronësisë së pronës së kërkuar nuk ka lidhshmëri me konfliktin e armatosur, Gjykata Supreme konsideron që vendimi i kundërshtuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 paragrafi 2 nënparagrafi (b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) i cili *mutatis mutandis* është aplikuar në procedurë pranë saj në përputhje me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Prandaj, vendimi i njëjtë i KKPK-së sipas nenit 198 paragrafi 1 i LPK-së duhet të anulohet dhe kërkesa e paraqitësit të kërkesës të hedhet poshtë.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20) duke marrë parasysh se vlera e pronës në fjalë më në mënyrës të arsyeshme mund të vlerësohet të jetë 35.000 €: 30 € (50€+0.5% e 35.000 € por jo më shume se 30 €).

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese e cila humb rastin. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e këtyre taksave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47 paragrafi 3 parashih që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX- it